



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 01**

**Datë: 07. 01. 2021. Ora: 15:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Aktivitetet e ZRPPC-së**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**-Këshilli për Personel**

-Shqyrtimi i draft -planit për angazhimin e stafit jo permanent;

**-Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës  
14.02.2021

-Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Republikës se Kosovës

## **-Këshilli për Buxhet dhe Financa**

-Shqyrtimi i Panit të Buxhetin për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Republikës se Kosovës;

### **4.Të ndryshme.**

---

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

**3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### **1.Këshilli për Personel**

Shqyrtimi i draft -planit për angazhimin e stafit jo permanent;

**( Nuk ka incizim të dëgjueshëm, deri këtu...! )**

**Alim Rama:** Sa herë që e kam ngritur çështjen e aplikacionit, përmendet reforma zgjedhore. Jo të çështjet që përmenden, nuk janë në ligj dhe ligjin e përcakton reforma. Edhe në procesin ekzistues, unë e kisha përmendur një aplikacion që e përdorë KQZ-ja dhe që nuk ceket në asnjë dokument këtu, një dokument që ua mundëson qytetarëve brenda Kosovës me e ndrru Qendrën e Votimit! I njëjti aplikacion, kishte mundur me u adaptue brenda ditës, them për një ditë eventualisht dy, për me ua dhanë mundësinë edhe atyre që janë jashtë Kosovës me aplikue, se nga vendvotimi 1, në vendvotim me postë ose në vendvotim 2, teknikisht nuk ka kurrfarë dallimi.

Mendoj se këtu, është në vullnetin e KQZ. Edhe me këto afate, ani se të shkurtër ka mundësi me u aplikue, kurset koha, dhe i jepet mundësia me votue... Edhe kursimi material, është më i mirë, i mundshëm...Ka kohë, dhe duhet aprovuar urgjentisht...

**Ibrahim Selmanaj:** Janë trajtuar të gjitha temat dhe modalitetet që kanë të bëjnë me zgjedhjet e jashtëzakonshme, përfshi këtu, edhe rekomandimet e auditorit. Dhe, në të njëjtën kohë, këshilli rekomandon KQZ-së që mbi bazën e kërkesave që kanë njësitë kërkuese dhe mbi bazën e planifikimit të saktë, mund të merr vendim kryeshefi dhe, nënse edhe rritet numri i pikantëve edhe ne i rrisim kapacitetet...

**Valdete Daka:** Gjithsesi, dhe ne t'i kthehemi pikës, e ajo ishte shqyrtimi i draft -planit për angazhimin e stafit jo permanent...E keni para vetes, një draft plan...

**Alim Rama:** Unë, duke ju referuar rregullores po vërej pasaktësi në faqen 1: zyrtaret e trajnimit janë në kuadër të departamentit të koordinimit të terrenit...! E në bazë të rregullores o1/2017, trajnimi është përgjegjësi e departamentit zgjedhor...pra, në KOZ...Të korrigjohet kjo, patjetër...

**Arianit Elshani:** Me këtë plan, mendoj që shumica e anëtarëve janë të kënaqur! Mirëpo, ne e kemi këtë plan, dhe unë përgëzoj administratën për këtë plan të bërë për kohë të shpejtë...Kemi diskutuar të gjithë në komisione, dhe kemi marrë edhe informacione dhe këtë çështje, do ta diskutojmë në këshilla, meqë i kemi edhe zgjedhjet lokale...! Mbase, meqë është praktikë, unë e mbështes në parim...

**Valdete Daka:** Ne, ta aprovojmë numrin, dhe pastaj nuk është problem, e diskutojmë...

**Alim Rama:** Ne, e kemi adresuar këtë çështje ! Kush është përgjegjës, dhe secila pozitë duhet të jetë brenda rregullores, kush – çka...!

**Valdete Daka:** Po, pajtohem me Alimin...dhe, zyrtarët e trajnimit janë pjesë e KOZ-it. Ne, ta aprovojmë planin, dhe pastaj të shqyrtohet edhe kjo kërkesë...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan draft -planit për angazhimin e stafit jo permanent.

## **2.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 14.02.2021:**

**Alim Rama:** E kemi trajtuar planin, dhe afatet janë gjithmonë të shkurtëra. Sekretariati ka bërë punën më të mirë të mundshme për me gjet kohë për secilën, kështu që unë mendoj se disa faza janë kryesore, dhe disa prej tyre, tashmë fillojnë të rrjedhin.

Z. Rama, përmendi disa prej specifikave kryesore, periudhën e planifikimit dhe zhvillimit të tyre sipas planit...

**Eshref Vishi:** Konsideroj se këto dy dokumente të mësipërme, janë bazike për procesin zgjedhor në të cilin po hyjmë. Ne, po hyjmë në një proces të jashtëzakonshëm dyfish, sepse e kemi edhe pandeminë. Ne, duhet të mbështetemi në ligj që ushtrojmë kompetenca me përgjegjësi, së bashku ta udhëheqim procesin në të gjitha fazat e zhvillimit dhe të administrimit të tij. Unë, dua ta nënvizoj vetëm një fakt: Sekretariati...

**Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Republikës se Kosovës**

**Arianit Elshani:** Lidhur me afatet kohore, edhe për subjektet politike dhe për kohën e shkurtër që të përpilohen listat e kandidatëve, ne kemi caktuar datën 16 janar që të përfundohet aplikimi për regjistrim të subjektet. Por, janë edhe obligimet tona s'i KQZ-së që kanë dalë nga vendimi i kushtetueses, ashtu s'i edhe për subjektet e tjera. Janë 10 ditë për fushatën zgjedhore, dhe nuk është prekur afati për diasporën, pastaj hartimi dhe thjeshtëzimi i dizajnit...

**Ibrahim Selmanaj:** E kemi marrë një vendim, që dorëzimi i dokumenteve të bëhet në orën 18:00.

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për aprovim të planit operacional.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë plan zgjedhor.

**Alim Rama:** Është edhe kalendari i operacioneve zgjedhore, nuk dua t'i përsërisë! Do të behën publike edhe për media. Qysh janë në plan operacional, të gjitha këto afate janë edhe s'i vendime, ndonëse janë afate të shkurtueme nga afatet e rregullta...

**Valdete Daka:** Ajo që është me interes edhe për subjektet politike dhe kandidatët e tyre është aplikimi që fillon me 8 janar, dhe përfundon më 16 janar. KQZ, nga 21-22 janar të bëjë certifikimin e tyre. Po ashtu, mbajtja e shortit për renditje në fletëvotim, do të bëhet më datën 1 shkurt 2021, si dhe fushata do të jetë nga data 3 shkurt, dhe përfundon më 12 shkurt. Afatet e jera do të jenë në ueb faqe...

### **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

Shqyrtimi i Panit të Buxhetin për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Republikës se Kosovës:

**Sami Hamiti:** Në këshill, kemi shqyrtuar planin e buxhetit për për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Republikës se Kosovës. E kemi shqyrtuar ngadalë, dhe kemi pasur parasysh uljen sa më të mundshme të shpenzimeve. Kemi një situatë të re, pra e kemi pandeminë prandaj, duhet përmbushur kriteret që kapin shumën rreth 150 mijë euro. Kjo, e rritë kosoton e buxhetit, e kemi parë në dy komunat që i mbajtm zgjedhjet...

Kategoria e mallrave dhe shpenzimeve përfshinë kodin zgjedhorë më të shtrenjtin, 3 e 800 mijë, pastaj kemi shërbimet kapitale, si dhe trupat zgjedhor që marrin 70 % të buxhetit. Sipas praktikave të institucioneve të tjera, janë edhe orët shtesë s'i pjesë, dhe shujtat që s'po përmenden. Ne, kemi lënë që kjo të trajtohet në KQZ, pra nuk e kemi shqyrtuar në këshill...

Mendojmë që është buxhet real, dhe këshilli unanimisht e ka votuar.

Në debat në këtë pikë, morën pjesë: Alim Rama, Burim Ahmetaj, Valdete Daka, Sami Kurteshi, Sami Hamiti, të cilët shqyrtuan, dhanë vërejtje, por edhe përgjigje në lidhje me këtë plan zgjedhor të buxhetit.

### **4.Të ndryshme.**